



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 324, Datë 14.11.2023

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.73, DATË 13.03.2023 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNPOWER 2017” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134/12 prot., datë 10.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr.73, datë 13.03.2023 “Mbi licencimin e shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 73, datë 13.03.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë “SUNPOWER 2017” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar, duke i lënë kushtin që të informojë ERE-n çdo 4 (katër) muaj mbi fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri në datën 22.04.2024.
- ERE, me shkresën me nr.134/9 prot., datë 16.03.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 73/2023 dhe me shkresën me nr.134/10 prot., datë 16.06.2023 i kujtoi asaj detyrimin për plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s.
- Në korrespondencën e zhvilluar me shoqërinë në lidhje me plotësimin e këtij kushti, ajo ka informuar ERE-n se është pajisur me Lejen e Ndërtimit.

- Më tej, në përgjigje të shkresës së ERE-s të datës 07.11.2023, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2056/10 prot., datë 08.11.2023, shoqëria ka informuar se në fund të muajit tetor 2023 ka filluar fazën e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltai.
- Me depozitimin e këtij informacioni, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73/2023, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.
- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 73/2023, shfuqizohet.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “SUNPOWER 2017” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI